




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 49 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.03.2012 miratoi këtë

VENDIM

Bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2010, në vitin fiskal 2012

I

Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2010, në vitin fiskal 2012.

II

Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 në shumë prej 26.051,31€ barten në:

Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 2.187,41€ Mallra dhe Shërbime,
Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 8.59€ Shpenzime komunale,
Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 9.00€ Subvencione dhe Transfere.
Programi 920 Arsimit dhe shkencë (nënprogrami 92135 Administrata e Arsimit) në shumë prej 23.846,31€ Paga dhe mëditje.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-23627
Gjilan, më 02.03.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues